VENDIM
Nr. 120, datë 20.10.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 67, DATË 19.12.2019, "PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME FIER SHA"

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.10.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projektvendimit për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 67, datë 19.12.2019, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a.",

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Fier (UK Fier) me shkresat nr. 262 prot., datë 30.4.2020, me lëndë "Plotësim dokumentacioni"; nr. 500, datë 9.7.2020, me lëndë "Plotësim dokumentacioni", ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), për zgjerimin e zonës së shërbimit, dy aktmiratime higjieno-sanitare, në të cilat përfshihen tri njësitë e tjera administrative Topojë, Dermenas dhe Libofsh, që kishin mbetur jashtë zonës së shërbimit të kësaj shoqërie.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të zgjerimit të zonës së shërbimit të UK Fier, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.
3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Fier me vendimin nr. 5, datë 3.2.2017; nr. 67 datë 19.12.2019, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a." me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe për zonën e shërbimit, si më poshtë:

Bashkia Fier:	Njësia Administrative Fier
	Qendër
	Portëz
	Frakull
	Cakran
	Mbrostar
	Levan

4. KKRR-ja, në vendimin nr. 67, datë 19.12.2019, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a." i rekomandoi shoqërisë UK Fier që të punonte në drejtim të pajisjes së sistemeve të furnizimit me ujë të të gjithë zonës së shërbimit, me aktmiratim higjieno-sanitar.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Fier është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

Në pikën 3, të vendimit të KKRR-së nr. 67, datë 19.12.2019, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a.", bëhen këto ndryshime:

Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Fier sh.a është Bashkia Fier.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani